



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2020:071531  
Datë: 26.02.2024  
Numri i dokumentit: 05376795

KF.nr.92/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu-KOSTT” Sh.A., me seli në rr. “Isa Boletini”, nr.39 në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.H., specialiste për çështje ligjore ARr, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit të ATK-së nr.26/2020 të datës 02.03.2020, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 12.02.2024 në prani të përfaqësueses të palës paditëse B.H., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË padia e paditësit “Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu-KOSTT” Sh.A., me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, si pas kalimit të afatit ligjor.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, me datë të pranimit në gjykatë me 18.06.2020, duke kërkuar anulim e vendimit nr. 26/2020 të datës 02.03.2020, dhe anulimin e Njoftim Vlerësimi të ATK-së, sa i përket trajtimit të borxheve të këqija lidhur me shërbimet e ofruara për KEK në periudhën 2008-2009 si rezultat i bashkërenditjes dhe mos pagesën e

faturave për muajin nëntor, dhjetor 2010, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 03.08.2021, ka theksuar se paditësi në padi kryesisht i ka përsëritur pretendimet e paraqitura në ankesën e tij, të cilat në procedurën ankimore në Departamentin e Ankesave, kanë qenë lëndë e shqyrtimit dhe vlerësimit, andaj e paditura ka mbetet tërësisht pran theksimeve të paraqitura në arsyetim të vendimit nr.26/2020 të datës 02.03.2020. Gjykatës i ka propozuar të refuzoj padinë e paditësi, dhe të vërtetoj Vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së nr.26/2020 të datës 02.03.2020 si i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor publik dhe pas shqyrtimit të padisë së paditësit të parashtruar me datë 18.06.2020, si datë e dorëzimit në Gjykatë, dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës respektivisht vendimit kontestues të të paditurës në të cilin figuron vula e pranimit nga ana e paditësit e datës 05.03.2020, dhe pas përlogaritjes së ditëve kalendarike, ka konstatuar se nuk mund të veprohet sipas kërkesëpadisë së parashtruar me padi, pasi që padia e paditësit “Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu-KOSTT” Sh.A., me seli në Prishtinë, është e ushtruar pas kalimit të afatit ligjor, sepse këtu paditësi me datë 05.03.2020 e ka pranuar vendimin kontestues nr.26/2020 i datës 02.03.2020, datë e cila dëshmohet me vulën e pranimit të vetë paditësit, e po ashtu edhe në padi theksohet se vendimi kontestues është pranuar me 02.03.2020, e ndaj të cilit vendim këtu paditësi ka pasur të drejtë padie në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit dhe si ditë e fundit e paraqitjes së padisë në Gjykatë ka qenë data 06.04.2020, (ditë e hënë), mirëpo këtu paditësi nuk e ka respektuar këtë afat ligjor ndërsa padinë e ka ushtruar jashtë afatit dhe atë me datë 18.06.2020, si datë e dorëzimit në Gjykatë, andaj bazuar në të gjitha të lartcekurat Gjykatë në seancë ka nxjerr aktvendim për hedhjen poshtë të paditës së paditësit, konform nenit 34 par.1 nën par. 1.1, dhe par 2 të nenit 34 të LKA-së.

Në nenin 34 par.1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative është parashikuar shprehimisht se “Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme”, ndërsa me par.2 është

përcaktuar se “Për shkaqe të parashikuara në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës.”

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të cekurat më lart, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 34, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe paragrafi 2 të nenit 34 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.92/22, datë 26.02.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.